



Suedi
Sverige



SANE
27
Supporting
Albanian
Negotiations
in Environment

Acquis e re dhe hapat e mëtejshëm në lidhje me periudhat tranzitore dhe të përshtatjes

Tryeza e Këshillimit dhe Diskutimit për kapitullin 27

Tiranë, 28 janar 2025

Acquis e re për Kapitullin 27

- ▶ Në mars 2023, u mbajt në Bruksel takimi i dytë sqarues në lidhje me ndryshimet që kishin ndodhur që nga takimi i parë sqarues dhe ndryshimet e pritshme në periudhën afatshkurtër (ky prezantim do prekë vetëm aktet post 2023).
- ▶ Qëllimi kryesor i nxjerrjes së akteve të reja është jetësimi i *EU Green Deal* dhe strategjive që lidhen me të
- ▶ Aktet e reja që do të paraqiten janë:
 - Akte të reja (nuk ka pasur akte që rregullonin këtë aspekt, p.sh. *Nature Restoration Law*)
 - *Recast** – Reformulimi (akte të reja që riformulojnë akte të mëparshme, p.sh. *Ambient Air Quality Directive*)
 - Amendimet (kryesisht do përmenden amendime domethënëse që ndryshojnë në masë të madhe një akt ekzistues p.sh. amendimi i *Emission Trading System Directive*)

* *Recast* bashkon në një akt të vetëm të ri ligjor të BE-së një akt legjislativ dhe të gjitha ndryshimet e tij të mëvonshme. Akti i ri i BE-së p.sh. Rregullorja, Direktiva ose Vendimi do të kalojnë në procesin e plotë legjislativ dhe do të shfuqizojnë të gjitha aktet ligjore të BE-së që janë riformuluar. *Recast* përfshin ndryshime të reja thelbësore, pasi ndryshimet bëhen në aktin origjinal të BE-së gjatë përgatitjes së tekstit të riformatuar, d.m.th. mund të ndryshojë dispozitat ekzistuese ose thjesht të përfshijë të reja.

Acquis e re për Legjislacionin Horizontal

- ▶ Directive (EU) 2024/1203 of the European Parliament and of the Council of 11 April 2024 on the **protection of the environment through criminal law** and replacing Directives 2008/99/EC and 2009/123/EC
- ▶ Hyrja në fuqi: maj 2026 – Direktiva Ekzistuese 2008/99/EC (Env Crime Directive)
- ▶ Aspektet e reja që prek direktiva:
 - ofron përkufizime më të qarta të krimeve mjedisore dhe standardizon atë që përbën sjellje të paligjshme.
 - përfshirja e veprave të reja demonstroi përshtatjen e Direktivës ndaj kërcënimeve mjedisore në zhvillim
 - paraqet dënime më të ashpra për shkelje të rënda që shkaktojnë dëme mjedisore afatgjata dhe të pakthyeshme
 - fokus të fortë në planifikimin dhe monitorimin, i cili pritet të përmirësojë zbulimin dhe ndjekjen penale të krimeve mjedisore.
 - kufizime kohore për hetimin dhe gjykimin e çështjeve dhe kufizime kohore për zbatimin e vendimeve si dhe qartësimin e juridiksionit
 - mbledhjen, standardizimin dhe shpërndarjen e statistikave më të plota për këto çështje

Acquis e re për Cilësinë e Ajrit

- Directive (EU) 2024/2881 of the European Parliament and of the Council of 23 October 2024 on **ambient air quality** and cleaner air for Europe (**recast**) and replacing Directives 2008/50/EC and 2004/107/EC
- Hyrja në fuqi: maj 2026 – Direktiva Ekzistuese 2008/50 (AAQD) dhe 2004/107 4th Daughter
- Aspektet e reja që prek direktiva:
 - shkurton vlerën kufi të lejuar vjetor për ndotësit kryesorë të ajrit
 - uljen e niveleve të lejuara për dymbëdhjetë ndotësit e ajrit: grimcat (PM_{2.5} dhe PM₁₀), dyoksidi i azotit (NO₂) dhe oksidet e azotit (NO_x), dyoksidi i squfurit (SO₂), ozoni (O₃), monoksidi i karbonit, benzeni, benzo(a)pireni, arseniku, kadmiumi, nikeli dhe plumbi.
 - sigurojnë veprime të hershme për të arritur ajër më të pastër
 - të mbështesë autoritetet lokale duke forcuar dispozitat për monitorimin dhe modelimin e cilësisë së ajrit dhe të ndihmojë në përmirësimin e planeve të cilësisë së ajrit.
 - autoritetet kombëtare dhe vendore do të përcaktojnë masat specifike të nevojshme për të përmbushur këto standarde
 - të sigurojë që personat që vuajnë nga problemet shëndetësore për shkak të ndotjes së ajrit të kenë të drejtën për t'u kompensuar, në rast të shkeljes së rregullave të BE-së për cilësinë e ajrit.

Acquis e re për Menaxhimin e Mbetjeve (Bateritë dhe Akumulatorët)

- ▶ Regulation (EU) 2023/1542 of the European Parliament and of the Council of 12 July 2023 concerning **batteries and waste batteries**, amending Directive 2008/98/EC and Regulation (EU) 2019/1020 and repealing Directive 2006/66/EC
- ▶ Hyrja në fuqi: gusht 2025 – Direktiva Ekzistuese 2006/66 (kaluar nga Direktivë në Rregullore)
- ▶ Aspektet e reja që prek rregullorja:
 - promovon ekonominë qarkulluese duke rregulluar gjithë ciklin e tyre të jetës
 - cakton objektiva për prodhuesit që mbledhin mbetjet e baterive portative
 - vendos një objektiv për rikuperimin e litiumit nga mbetjet e baterive
 - parashikon nivele minimale të detyrueshme të përmbajtjes të ricikluar për bateritë industriale, SLI dhe bateritë EV
 - siguron objektivin e efikasitetit të riciklimit për bateritë nikel-kadmium
 - paraqit kërkesat e etiketimit dhe informacionit, ndër të tjera për komponentët e baterisë dhe përmbajtjen e ricikluar, si dhe një "pasaportë baterie" elektronike dhe një kod QR.
 - vendos rregulla të rrepta të "due diligence" për operatorët të cilët duhet të verifikojnë burimin e lëndëve të para të përdorura për bateritë e vendosura në treg.

Acquis e re për Menaxhimin e Mbetjeve (Ambalazhet dhe Mbetjet e tyre)

- ▶ Regulation (EU) 2025/40 of the European Parliament and of the Council of 19 December 2024 on **packaging and packaging waste**, amending Regulation (EU) 2019/1020 and Directive (EU) 2019/904, and repealing Directive 94/62/EC
- ▶ Hyrja në fuqi: gusht 2026 – Direktiva Ekzistuese 94/62 (kaluar nga Direktivë në Rregullore)
- ▶ Aspektet e reja që prek rregullorja:
 - vendos objektiva për 2030 dhe 2040 për një përqindje minimale të përmbajtjes së ricikluar
 - minimizimi i peshës dhe vëllimit të ambalazhit dhe shmangia e paketimeve të panevojshme
 - minimizimi i substancave problematike, duke përfshirë kufizimin e vendosjes në treg të ambalazheve në kontakt me ushqimin që përmbajnë substancat per-and polifluoroalkile (PFAS) nëse ato tejkalojnë pragjet e caktuara
 - vendos kufizime për ambalazhet plastike një përdorimëshe
 - vendos objektiva të reja të ripërdorimit të detyrueshëm për vitin 2030 dhe objektiva parashikues për vitin 2040
 - bizneset e kateringut do të duhet t'u ofrojnë klientëve mundësinë që të sjellin kontejnerët e tyre për t'i mbushur me pije të ftohta ose të nxehta ose ushqime të gatshme, pa pagesë shtesë.

Acquis e re për Menaxhimin e Mbetjeve (Transporti i Mbetjeve)

- ▶ *Regulation (EU) 2024/1157 of the European Parliament and of the Council of 11 April 2024 on shipments of waste, amending Regulations (EU) No 1257/2013 and (EU) 2020/1056 and repealing Regulation (EC) No 1013/2006*
- ▶ *Hyrja në fuqi: maj 2026 – Rregullorja Ekzistuese 1013/2006*
- ▶ *Aspektet e reja që prek rregullorja:*
 - *përcakton procedurat moderne të dixhitalizuara për të lehtësuar dhe gjurmuar më mirë dërgesat e mbetjeve brenda BE-së*
 - *inkurajimi i mbetjeve që të rihyjnë në ekonominë qarkulluese në të gjithë BE-në, pa ulur nivelin e nevojshëm të kontrollit për dërgesa të tilla*
 - *siguron zbatim dhe bashkëpunim më të fortë në luftën kundër trafikimit të mbetjeve*
 - *lehtëson bashkëpunimin më të ngushtë ndërmjet shteteve anëtare të BE-së dhe siguron më shumë sanksione parandaluese kundër kriminelëve të përfshirë në tregtinë e paligjshme të mbetjeve*

Acquis e re për Cilësinë e Ujit

- ▶ *Directive (EU) 2024/3019 of the European Parliament and of the Council of 27 November 2024 concerning **urban wastewater treatment (recast)***
- ▶ *Hyrja në fuqi: gusht 2027 – Direktiva Ekzistuese 91/271 (UWWT)*
- ▶ *Aspektet e reja që prek direktiva:*
 - *mbledhja dhe trajtimi i ujërave të përdorura në të gjitha zonat urbane me më shumë se 1000 banorë*
 - *heqja e më shumë nutrientëve (lëndëve ushqyese) që përndryshe do të shkaktonin eutrofikim të dëmshëm me trajtimin terciar.*
 - *heqja e mikrondotësve me trajtim kuaternar, financuar nëpërmjet skemës së përgjegjësisë së zgjeruar të prodhuesit nga sektorët përgjegjës për ndotjen*
 - *kthimi i impianteve të trajtimit në energji-neutral dhe zvogëlimi i shkarkimeve të gazeve serrë deri në vitin 2045.*
 - *monitorimin i ujërave të përdorura për parametrat shëndetësorë, si SARS-Covid dhe rezistencën anti-mikrobike.*

Acquis e re për Mbrojtjen e Natyrës

- Regulation (EU) 2024/1991 of the European Parliament and of the Council of 24 June 2024 on **nature restoration**
- Hyrja në fuqi: shtator 2024 – Direktiva Ekzistuese (akt i ri)
- Aspektet e reja që prek rregullorja:
 - objektiva të bazuara në legjislacionin ekzistues (për ligatinat, pyjet, kullotat, lumenjtë...) - përmirësimi dhe rivendosja e habitateve të biodiversitetit në një shkallë të gjerë dhe rikthimi i popullatave të specieve duke përmirësuar dhe zgjeruar habitatet e tyre
 - **insektet pjalmuese** – kthimin mbrapsht të rënies së popullatave të pjalmuesve deri në vitin 2030 dhe arritjen e një tendence ritëse për popullatat e pjalmuesve, me një metodologji për monitorimin e rregullt të pjalmuesve
 - **ekosistemet pyjore** – arritja e një tendence ritëse për drurët, pyjet me moshë të pabarabartë, lidhshmërinë e pyjeve, bollëkun e shpendëve të zakonshëm të pyjeve dhe stokun e karbonit organik
 - **ekosistemet urbane** – asnjë humbje neto e hapësirës së gjelbër urbane dhe mbulesës me pemëve deri në vitin 2030, dhe një rritje e qëndrueshme në sipërfaqen e tyre totale që nga viti 2030
 - **ekosistemet bujqësore** – rritja e fluturave të kullotave dhe zogjve të tokës bujqësore, stoku i karbonit organik në tokat minerale të tokës bujqësore dhe pjesa e tokës bujqësore me karakteristika peizazhi me diversitet të lartë
 - **ekosistemet detare** - rimëkëmbja e habitateve detare si ato me bimë ose me sedimentim që sjellin përfitime të rëndësishme, përfshirë zbutjen e ndryshimeve klimatike, dhe rimëkëmbjen e habitateve të specieve ikonike detare si delfinët, peshkaqenë dhe shpendët detarë
 - **ndërlidhja e lumenjve** - identifikimi dhe heqja e barrierave që pengojnë ndërlidhjen e ujërave sipërfaqësore, në mënyrë që të paktën 25.000 km lumenj të rikthehen në gjendje të rrjedhjes së lirë deri në vitin 2030

Acquis e re për Kontrollin e Shkarkimeve Industriale

- *Directive 2010/75/EU of the European Parliament and of the Council of 24 November 2010 on industrial and livestock rearing emissions (integrated pollution prevention and control) (**recast**)*
- *Hyryja në fuqi: gusht 2027 – Direktiva Ekzistuese 2010/75 (amendim përmes 2024/1785 dhe Rregullorja e re 2024/1244 shfuqizon E-PRTR)*
- *Aspektet e reja që prekin amendimet:*
 - *promovon inovacionin dhe transformimin përmes teknikave më efektive të reduktimit të shkarkimeve.*
 - *shtrëngon rregullat për reduktimin e shkarkimeve me vlera më strikte të shkarkimeve dhe kushte më të rrepta për dhënien e shtyrjeve.*
 - *siguron mjete të reja dhe më të forta për ekonominë qarkulluese dhe eficientë të burimeve, si dhe redukton përdorimin e kimikateve të rrezikshme.*
 - *mbulon më shumë aktivitete për të ulur shkarkimet e parregulluara (nxjerrja e metaleve, prodhimi i baterive, venddepozitimet e mbetjeve dhe fermat intensive të derrave dhe shpendëve).*
 - *rrit të drejtat e publikut duke forcuar dhe zgjeruar informacionin publik, pjesëmarrjen dhe aksesin në drejtësi, si dhe duke i lejuar njerëzit të kërkojnë kompensim për dëmet në shëndetin e tyre të shkaktuara nga ndotja e paligjshme*

Acquis e re për Ndryshimet Klimatike (Sistemi i Tregtimit të Shkarkimeve – ETS)

- ▶ *Directive 2003/87/EC of 13 October 2003 establishing a scheme for greenhouse gas emission allowance trading within the Community*
- ▶ *Hyrja në fuqi: janar 2024 – Direktiva Ekzistuese 2003/87 (amendim përmes 2023/959 dhe Rregullorja e re 2024/2493 amendon MMR 2018/2066)*
- ▶ *Aspektet e reja që prekin amendimet:*
 - *siguron mbrojtje efektive të vazhdueshme për sektorët e ekspozuar ndaj një rreziku të konsiderueshëm të rrjedhjes së karbonit dhe stimulon përdorimin e teknologjive me karbon të ulët.*
 - *adreson efektet sociale dhe të barazisë të këtij tranzicioni.*
 - *siguron që sektorët që nuk përfshihen në ETS të BE-së të kontribuojnë me kosto efektive në reduktimin e shkarkimeve.*
 - *rishikon sistemin e monitorimit, raportimit dhe verifikimit të emetimeve të CO2 nga disa sektorë.*
 - *rishikon Rezervën e Stabilitetit të Tregut (MSR) në përputhje me detyrimin ligjor përkatës*
 - *vlerësim zero i shkarkimeve nga disa lëndë djegëse me karbon të ulët, si karburantet e rinovueshme me origjinë jobiologjike dhe karburantet sintetike me karbon të ulët*
 - *rregulla të përmirësuara për biokarburantet dhe karburantet e qëndrueshme për aviacion*

Acquis e re për Ndryshimet Klimatike (Sistemi i Tregtimit të Shkarkimeve – ETS)

- ▶ *Directive 2003/87/EC of 13 October 2003 establishing a scheme for greenhouse gas emission allowance trading within the Community*
- ▶ *Hyrja në fuqi: janar 2024 – Direktiva Ekzistuese 2003/87 (amendim përmes 2023/959 dhe Rregullorja e re 2024/2493 amendon MMR 2018/2066)*
- ▶ *Aspektet e reja që prekin amendimet:*
 - *siguron mbrojtje efektive të vazhdueshme për sektorët e ekspozuar ndaj një rreziku të konsiderueshëm të rrjedhjes së karbonit dhe stimulon përdorimin e teknologjive me karbon të ulët.*
 - *adreson efektet sociale dhe të barazisë të këtij tranzicioni.*
 - *siguron që sektorët që nuk përfshihen në ETS të BE-së të kontribuojnë me kosto efektive në reduktimin e shkarkimeve.*
 - *rishikon sistemin e monitorimit, raportimit dhe verifikimit të emetimeve të CO2 nga disa sektorë.*
 - *rishikon Rezervën e Stabilitetit të Tregut (MSR) në përputhje me detyrimin ligjor përkatës*
 - *vlerësim zero i shkarkimeve nga disa lëndë djegëse me karbon të ulët, si karburantet e rinovueshme me origjinë jobiologjike dhe karburantet sintetike me karbon të ulët*
 - *rregulla të përmirësuara për biokarburantet dhe karburantet e qëndrueshme për aviacion*

Acquis e re për Ndryshimet Klimatike (Gazet e Fluoruar)

- ▶ Regulation (EU) 2024/573 of the European Parliament and of the Council of 7 February 2024 on fluorinated greenhouse gases, amending Directive (EU) 2019/1937 and repealing Regulation (EU) No 517/2014
- ▶ Hyrja në fuqi: mars 2024 – Rregullorja Ekzistuese 517/2014 (zëvendësim)
- ▶ Aspektet e reja që prek rregullorja:
 - **reduktimi i hidrofliorokarbureve** – Sistemi i kuotave gjeneron një ulje më të madhe të sasive që importuesit dhe prodhuesit mund të vendosin në tregun e BE-së dhe në vitin 2050, HFC-të do të hiqen në BE.
 - **zgjerimi i sistemit të kuotave** – HFC-të e përdorura në inhalatorët me dozë të matur janë integruar në sistemin e kuotave. Ndalime shtesë për pajisjet e gazit të fluoruara, produktet dhe përdorimin e gazeve të fluoruara do të zbatohen në të ardhmen.
 - **rregulla më të rrepta për të parandaluar shkarkimet** – rregullorja mbulon pajisjet dhe gazrat shtesë, duke zgjeruar masat për të parandaluar rrjedhjet gjatë transportit, instalimit, shërbimeve dhe asgjësimit të pajisjeve dhe produkteve.
 - **lehtësimi i monitorimit** – më shumë digjitalizim dhe automatizim elektronik i kontrollit doganor do të lejojë zbatimin dhe monitorimin e zgjeruar në Shtetet Anëtare dhe luftimin e tregtisë së paligjshme.
 - **Kufizimi i prodhimit të HFC-ve në BE** - Duke filluar nga viti 2025, prodhuesit do të marrin të drejta ekuivalente me 60% të prodhimit mesatar vjetor nga viti 2011 deri në 2013. Kjo normë do të bjerë në 15% deri në vitin 2036.

Acquis e re për Ndryshimet Klimatike (Substancat ozonholluese)

- *Regulation (EU) 2024/590 of the European Parliament and of the Council of 7 February 2024 on substances that deplete the ozone layer, and repealing Regulation (EC) No 1005/2009*
- *Hyrja në fuqi: mars 2024 – Rregullorja Ekzistuese 1005/2009 (zëvendësim)*
- *Aspektet e reja që prek rregullorja:*
 - *paraqet kërkesat për rikuperimin dhe riciklimin e substancave të tilla në materialet e ndërtimit gjatë rinovimeve (që gjenden veçanërisht në shkumat izoluese), që është burimi kryesor i shkarkimeve të mbetura të ODS në BE..*
 - *paraqit përjashtime strikte për përdorimin e tyre si lëndë e parë (për të prodhuar substanca të tjera, për shembull në industrinë farmaceutike ose kimike), si agjentë përpunues, në laboratorë dhe për mbrojtjen nga zjarri.*

Pyetje dhe...
Faleminderit për vëmendjen!